

Data 17.05.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“ Transformimi Urban ne Hapesira Publike Kryesore Rajoni 2” Projekt Zbatimi “Bulevardi I Dibres”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 225,000,000 *(dyqind e njëzetë e pesë milion)* Lekë pa TVSH. Programi buxhetor për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 22AA103

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme *(Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga

vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontrates në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entetet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë*

kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

i) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

ii) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë kategoritë e licencës si më poshte:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P -	1.	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	3.	B	Rikonstruksion dhe mirembajtje civile dhe industrial, veshje fasada.
N.P -	4.	D	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.P -	7.	A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.
N.P -	11.	A	Ndertime per N/stacionet, kabinat e transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise
N.P -	12.	A	Punime te inxhinerise se mjedisit.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

N.S –	1.	A	Punime per prishjen e ndertimeve
N.S -	4.	A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
N.S –	6.	A	Sinjalistike rrugore jondricuese
N.S –	8.	A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
N.S -	18.	A	Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gërmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> • Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet • Transport dheu me auto deri 5.0 km • Gërmim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet • Transport dheu me auto deri 5.0 km • 	0-20 mln leke	2,422,213 leke
N.P- 3 B	Rikonstrukcion dhe mirembajtje e godinash, civile, dhe industrial, veshje	<ul style="list-style-type: none"> - Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi - "Veshje muri brenda me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete - + suva grafiato." - Boje hidroplastike cilesi e larte - Veshje fasade me pllaka guri (t=2-3cm) 	21-50 mln leke	23,734,462 leke
N.P - 4. D	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	<ul style="list-style-type: none"> • Fv.Shtirim sheshi me gure 10cm (sipas specifikimit ne raportin teknik) • Shtrese betoni C 16/20 (Me cakell) t=5-10cm, per nivelim • Shtrese betoni C16/20 (Me cakell) per kanalet e kullimit • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (zgare ø8/20cm) • Shtrese asfaltbetoni me çakell e rashinuar, t=5cm • Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri 	101-200 mln leke	138,223,712 leke
N.P - 7. A	Ujesjellesa ,	<ul style="list-style-type: none"> - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm 	0-20 mln leke	8,192,331 leke

	gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.	<ul style="list-style-type: none"> - Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 150 cm, kapak gize - Shtrese rere - Nenshtrese zhavori (mbushe kanali me zhavorr) - Ulluk shkarkimi horizontal me llmarine baker 33cm - Ulluk shkarkimi vertikal me llmarine baker Ø 120 - 		
N.P - 11. A	Ndertime per N/stacionet , kabinat e transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	<ul style="list-style-type: none"> • Shtylla ndricimi Ip65 LED /3000 K • Shirit Led Ip65 10Wat /3000 K • Transformator 120 Wat per shirit LED • Spot inkaso tokesore IP65 (inoksi) 12volt • Spot inkaso prozhekor me fiksime dhe IP65 3000K 12volt • FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 • F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement • Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A • F.V. morseteri shtylle 3P=sig.16A+kapak • FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm • F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x10mm2 • F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm2 • F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 3x1.5mm2 • F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=75mm per elektrik • Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 200 cm, me kapak gize • Struktura monolite betoni C 12/15 • F.V. shirit sinjalizimi per kablllo • 	0-20 leke mln	12,845,569 leke
N.P-12 A	Punime te inxhinjerise se mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> • Hedhje,mbushje ngjeshje dheu të gërmuar,në kanal,tokë e butë (Hedhje humus për lulishtet) • Mbjellje bari ne skarpat • F.V. Fidane Peme dekorative • F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar • F.V. Fidane Lule dekorative • Kend lojrash 	0-20 leke mln	4,660,736 leke
N.S-1. A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Prishje shtrese pllaka guri ekzistuese • Prishje suvatim i jashtem • Prishje struktura prej guri • Prishje struktura prej betoni (per kanalet e KUN dhe KUB) • Prishje çatie ekzistuese me tjegulla • Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh • Çmontim i shtylle egzistuese 	0-20 leke mln	5,376,846 leke
N.S-4. A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri,	<ul style="list-style-type: none"> • Heqje dritare ekzistuese • F V dritare d/alumini plastike me dopio xham • F V dyer d/alumini plastike me dopio xham • Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri • FV Prague dritare mermeri, t=3cm "JANINA" • Korniza dekorative polistiroli (per dyer e dritare ne fasada) 	0-20 leke mln	15,144,669 leke

	plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.			
N.S-6. B	Sinjalistike rrugore jondricues e	<ul style="list-style-type: none"> - Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm.Termoplastike (sprajt) - Vizime me boje termoplastike (sprajt), vizime kembesoresh, shigjeta drejtimi etj) - F.v. Tabele katërkëndore "shërbimi" normal 60x90 (Parking) - FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm - Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30 (STOP) - FV tabela rrugore treguese 60x20cm 	0-20 mln leke	212,985 leke
N.S-8. A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	<ul style="list-style-type: none"> - Kend lojrash - Kosha - Shkalle montazhi mermeri - Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama - Stola betoni - Volume betoni (devijues trafiku) - Zgara gize per mbrojtjen e trungut te pemeve 	0-20 mln leke	9,933,080 leke
N.S-18. A	Punime topogjeode zike.	<ul style="list-style-type: none"> - Referuar projektit dhe specifikimeve teknike 		

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe regjistruar, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e **personelit kryesor** në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates,

specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

- *Prishje struktura prej guri*
- *Prishje shtrese pllaka guri ekzistuese*
- *Prishje suvatim i jashtëm*
- *Prishje struktura prej betoni (per kanalet e KUN dhe KUB)*
- *Prishje çatie ekzistuese me tjegulla*
- *Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh*
- *Çmontim i shtylle egzistuese*
- *Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet*
- *Transport dheu me auto deri 5.0 km*
- *Fv.Shtrim sheshi me gure 10cm (sipas specifikimit ne raportin teknik)*
- *Shtrese betoni C 16/20 (Me cakell) t=5-10cm, per nivelim*
- *Shtrese betoni C16/20 (Me cakell) per kanalet e kullimit*
- *F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm (zgare ø8/20cm)*
- *Shtrese asfaltobetoni me çakell e rashinuar, t=5cm*
- *Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri*
- *Struktura monolite betoni C 12/15*
- *Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet*
- *Transport dheu me auto deri 5.0 km*
- *Çati vendi e zakonshme me HD~8m, tjegulla vendi*
- *Veshje me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva grafiato."*
- *Boje hidroplastike cilesi e larte*
- *Veshje fasade me pllaka guri (t=2-3cm)*
- *Heqje dritare ekzistuese*
- *F V dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *F V dyer d/alumini plastike me dopio xham*
- *Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri*
- *FV Pragje dritare mermeri, t=3cm "JANINA"*

- Korniza dekorative polistiroli (per dyer e dritare ne fasada)

1 (nje) Inxhinier Elektrik

- Shtylla ndricimi Ip65 LED /3000 K
- Shirit Led Ip65 10Wat /3000 K
- Transformator 120 Wat per shirit LED
- Spot inkaso tokesore IP65 (inoksi) 12volt
- Spot inkaso prozhekor me fiksim ne dhe IP65 3000K 12volt
- FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086
- F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement
- Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A
- F.V. morseteri shtylle 3P=sig.16A+kapak
- FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm
- F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x10mm²
- F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm²
- F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 3x1.5mm²
- F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=75mm per elektrik
- Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 200 cm, me kapak gize
- F.V. shirit sinjalizimi per kablllo

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm
- F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm
- Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 150 cm, kapak gize
- Shtrese rere
- Nenshtrese zhavori (mbushe kanali me zhavorr)
- Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine baker 33cm
- Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine baker Ø 120

1 (nje) Inxhinier Mekanik

- Kend lojrash
- Kosha
- Shkalle montazhi mermeri
- Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama
- Stola betoni
- Volume betoni (devijues trafiku)
- Zgara gize per mbrojtjen e trungut te pemeve
- Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm.Termoplastike (sprajt)
- Vizime me boje termoplastike (sprajt), vizime kembesoresh, shigjeta drejtimi etj)
- F.v. Tabele katërkëndore "shërbimi" normal 60x90 (Parking)
- FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm
- Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30 (STOP)
- FV tabela rrugore treguese 60x20cm

1 (Nje) Inxhinier Mjedisi

- *Hedhje, mbushje ngjeshje dheu të gërmuar, në kanal, tokë e butë (Hedhje humus për lulishtet)*
- *Mbjellje bari ne skarpat*
- *F.V. Fidane Peme dekorative*
- *F.V mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar*
- *F.V. Fidane Lule dekorative*

1 (Nje) Inxhinier Gjeodet

- *Referuar projektit dhe specifikimeve teknike*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqytjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të

brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 80 persona** për periudhën, (shkurt 2024 - prill 2024) e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (shkurt 2024 - prill 2024).

Për përbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje (Shkurt 2024 – Prill 2024), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 80 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriteret e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, I ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Nga llogaritja e orëve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhte:

Total ore pune= 199,680 ore (sipas zerave të preventivit)

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune puntori= 199,680 ore/8 ore= 24,960 dite pune

Dite pune gjithesej= 12 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 26 dite= 312 dite

Numri I fuqise puntore = 24,960 dite/312 dite= 80 puntore

Ne menyre te permbledhur numri I fuqise puntore qe kerkohet per realizimin e punimeve eshte: 199,680 ore / 8 ore pune ne dite/ 312 dite pune= **80 puntore**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.

Nr.	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi	
1	Eskavator me goma	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	Prishje shtrese pllaka guri ekzistuese Prishje suvatim i jashtem Prishje struktura prej guri Prishje struktura prej betoni (per kanalet e KUN dhe KUB) Prishje çatie ekzistuese me tjegulla Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh Çmontim i shtylle egzistuese Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet
2	Eskavator me zinxhire	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	Transport dheu me auto deri 5.0 km Shtylla ndricimi Ip65 LED /3000 K Shirit Led Ip65 10Wat /3000 K Transformator 120 Wat per shirit LED Spot inkaso tokesore IP65 (inoksi) 12volt Spot inkaso prozhekor me fiksime ne dhe IP65 3000K 12volt
3	Eskavator me zinxhire me cekic	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A F.V. morseteri shtylle 3P=sig.16A+kapak
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 24 ton	Copë	4	Ne pronesi ose me qera	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x10mm ² F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm ² F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 3x1.5mm ² F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=75mm per elektrik Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 200

4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	cm, me kapak gize Struktura monolite betoni C 12/15 F.V. shirit sinjalizimi per kablllo SHUMA 4 PUNIME K.U.Z Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet
5	Kamionçinë (deri në 6 ton)	Copë	4	Ne pronesi ose me qera	Transport dheu me auto deri 5.0 km Shtrese asfaltobetoni me çakell e rashinuar, t=5cm Shtrese binderi me zall lavatrice,6cm,me makineri
6	Gurëthyes, frontoje	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	
7	Fabrikë asfalti	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	
8	Impiant automatik betoni	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	
9	Autobitumatriçe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	
10	Asfalto-shtruese	Copë	1	Ne pronesi ose me qera	
11	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton)	Copë	2	Ne pronesi ose me qera	

12	Rrul asfalti me gome - hekur (Kapaciteti jo me pak se 4 ton)	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
13	Kompresor	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
14	Autobot uji me sprucator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
15	Autobetoniere	Copë	3	Ne pronesi ose me qera
16	Mjet autovinç	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
17	Fadrome Kove perpara dhe mbrapa	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
18	Pompe betoni	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
19	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto

sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjese e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët 60
2. Punimet e ngjashme specifike (volumet)	pikët 15
3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët 15
4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 60] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Punimet e ngjashme specifike (volumet)

[0 –15 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kriter duhet të provojë se zotëron në eksperiencat e mëparshme të ngjashme kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

Punime të ngjashme për:

-Punime për ndërtimin e shesheve me pllake guri (përfshirë punimet për shtresat, punimet për ndricimin e tyre, mobilimin urban, etj.) me sipërfaqe jo më pak se 13,643 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit.

-Punime betoni jo më pak se 1205 m³ për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 mujore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike

Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë "0" pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = V_{\max k2} \times P_{\max k2} / O_{k2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k2}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)
$P_{\max k2}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Përbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikes 2.3.1 të Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1)

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qënë i detyruar të zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe pajisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k2} = V_{\max k2} \times P_{\max k2} / O_{k2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k2}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = V_{\max k4} \times P_{\max k4} / O_{k4}$$

P_{k4}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k4}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k4}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k4}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.